



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 187, Datë 12.09.2024

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “DRIBEN” SH.P.K. PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1, 3 dhe 7 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.09.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1857/1 prot., datë 09.09.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “DRIBEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “DRIBEN” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1857 prot., datë 03.09.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 2 MW, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Shoqëria nuk ka kryer pagesën e aplikimit për llogari të ERE-s, sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, dokumentacion i cili konsiderohet thelbësor, ndaj vlerësohet mosfillimi i procedurës për këtë aplikim.
- Në mbështetje të parashikimeve të nenit 10, pikës 7 të Rregullores nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijani e vendimit për mosfillimin e procedurës, kryen pagesën e

aplikimit, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DRIBEN” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bahskia Fier, Qarku Fier.
2. Nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijani e vendimit për mosfillimin e procedurës, kryen pagesën e aplikimit, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për fillimin e procedurës.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “DRIBEN” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI